

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kandidatët për anëtarë të KLGJ prezantojnë platformat: Jemi në momente sprove, ta bëjmë gjyqësorin më të mirë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/25/kandidatet-per-klgj-prezantojne-platformat-jemi-ne-momente-sprove-ta-bejme-gjyqesorin-me-te-mire65564/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:22:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 09:01:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 09:00:00 UTC → 25 shtator 2026, 09:02:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4bd64a442c61d1ea370ce4abf6f85d9ca4024473c3ebf0d04a1ba5f08a0a5e86
TEKSTI	c1e142624b2a4ffe70ac568621e2e194f1f762b6588a94d995d605cd9dddcda3
PAMJA	2a7fd4a22d48c7ce1d281e9679440318e9e0492c11890b28f7dd9606b774375b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dfa7215ba53f62923bc91ac63d8854c44fc2d6b3370a609b1fbc74aa83af2559
E MËPARSHMJA	954cb8c8d0e16f2693b3a55f6e8ca82ad8c6c21459c22fe865f79c97730dd487
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dfa7215ba53f62923bc91ac63d8854c44fc2d6b3370a609b1fbc74aa83af2559>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET **KRYESORE** **TË FUNDIT**

Kandidatët për anëtarë të KLGJ prezantojnë platformat: Jemi në momente sprove, ta bëjmë gjyqësorin më të mirë

25/09/2026 11:01



Në procesin për zgjedhjen e tre anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, siç raporton gazetarja Anila Hoxha, e pranishme në mbledhje, kandidatët që garojnë për përfaqësimin e Gjykatës së Lartë kanë prezantuar qëndrimet dhe prioritetet e tyre për pesë vitet e ardhshme.

Arbena Ahmeti, kandidate për KLGJ nga Gjykata e Lartë, u ndal te nevoja për bashkëpunim më të madh institucional dhe mbështetjen ndaj gjyqtarëve.


"KLGJ duhet të bashkëpunojë aktivisht me institucionet përgjegjëse. Shoqatat e gjyqtarëve përballen me mungesë fondesh dhe infrastrukture, ndaj Këshilli duhet të ofrojë mbështetje", u shpreh Ahmeti.

Ajo kërkoi gjithashtu besimin e kolegëve për mandatin e ardhshëm: "Nëse më jepni besimin tuaj për pesë vitet e ardhshme, premtoj që do të kemi një gjyqësor të mirë".



Sandër Simoni, kandidat për KLGJ nga Gjykata e Lartë, e vlerësoi situatën e sistemit gjyqësor si një periudhë konsolidimi dhe njëkohësisht sprove.

"Pushteti gjyqësor është në një fazë konsolidimi dhe në momente sprove, për shkak të ngarkesës në punë", tha Simoni.



I Kryesore



"Të vijojë lufta ndaj korrupsionit"/ Nga komandant i NATO-s në ambasador në Tiranë. Media në SHBA: Si e gjen Eric Wendt Shqipërinë

12:32

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim

09:59

Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë

10:41

Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje

09:47

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

10:27

I Më të lexuarat

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlorë Hyseni në SPAK

"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisarariatit Krujë

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministria Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Lashë në mes përkthimin e librit të ish-shefit të kundërzbulimit të STAS-it", rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burqu ish-drejtresha, Elisabeta Matai



Ai iu referua edhe disa prej çështjeve që kanë vënë në provë sistemin gjatë kësaj periudhe: “Ngjarja e rëndë e humbjes së kolegut dhe konflikti i pagave ishin sprovë, së pari për garantimin e sigurisë dhe për respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”.

Ndërkohë, Fatri Islamaj, kandidat për KLGJ nga Gjykata e Apelit, u ndal te sfidat me të cilat përballlet sistemi gjyqësor.



“Sfidat janë të shumta. Agresioni i paprecedentë me të cilin u përballëm gjatë këtij muaji për pagat përbën goditjen më arrogante”, deklaroi Islamaj.

Ai renditi edhe disa prej prioritetëve që, sipas tij, duhet të ketë KLGJ-ja: “Përshejtim në kohë të vlerësimit të gjyqtarëve, rishikim të numrit të gjyqtarëve, sidomos në gjykatat ku ka stok, si dhe përmirësim të infrastrukturës. KLGJ duhet të jetë më pranë gjykatave”.

Igerta Hysi, kandidate për KLGJ nga Gjykata e Apelit të Posaçëm, u ndal te promovimi i gjyqtarëve, cilësia e vendimeve dhe funksionimi i administratës gjyqësore.



“Secili nga ne duhet të ketë bindjen se promovimi nuk varet nga afërsia me KLGJ-në, por nga aftësia dhe puna. Besimin që kërkojmë nga qytetarët duhet ta ndiejmë vetë nga brenda sistemit”, u shpreh Hysi.


Ajo tha se do të mbështesë përmirësimin e arsytimit dhe kohës së dhënies së vendimeve, duke vënë theksin te cilësia dhe jo vetëm te statistikën. “Do të mbështes arsytimin në kohë të vendimeve, por gjithashtu jo vetëm statistika, por sidomos cilësi vendimesh”, tha Hysi. Sipas saj, një rëndësi të veçantë ka edhe administrata gjyqësore.

Top Story/ “Mbrotja do jetë arrogante”, Vangjeli për deklaratën e Vlorë Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt

Top Story/ “Hakmarrja është intimidimi i Klodiana Lalës”, Murizi për Vlorë Hysenin: Ajo e di kush ka hyrë e kush ka dalë nga zyra e Agasit

"Një gjyqtar nuk mund ta bëjë i vetëm punën, ndaj administrata meriton respekt dhe mbështetje. Duhet rishikuar shtimi i numrit të ndihmësve ligjorë", shtoi ajo.

Ndërkohë, Brunilda Kadi, kandidate për KLGJ nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, u mbështet te përvoja e saj e mëparshme në Këshill dhe karriera në sistemin gjyqësor.



"Përvoja e mëparshme gjatë mandatit të parë, nga 2016 deri në 2021, dhe karriera në gjyqësor më kanë ndihmuar ta njoh më mirë sistemin", tha Kadi.

Ajo u shpreh se gjatë mandatit të parë kishte kuptuar nevojën që KLGJ-ja të krijonte identitetin e vet, ndërsa pas rikthimit në sistem ishte përballur me sfida të reja. "Gjatë mandatit të parë kuptova se Këshilli duhet të krijonte identitetin e vet. Kur u riktheva, u përballa me sfida të tjera me të cilat ndeshet gjyqësori, pasi KLGJ nuk dëgjon gjyqtarët vetëm kur problemi është bërë i padurueshëm", deklaroi ajo.

Kadi e cilësoi detyrën e gjyqtarit si një përgjegjësi të veçantë. "Kemi zgjedhur detyrën më sublime dhe më të vështirë, pra dhënien e drejtësisë. Kjo nuk është një punë, por një mision", u shpreh kandidatja.

Manjola Xhaxhi, kandidate për KLGJ nga gjykatat e shkallës së parë, e vuri theksin te nevoja për forcimin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe te kushtet në të cilat punojnë gjyqtarët.



"Duhet të ndërtojmë një drejtësi të fortë dhe të pavarur. Shumë prej vështirësive tona lidhen me infrastrukturën. Nevojiten ambiente të sigurta. Situata kërkon ndërhyrje emergjente në Gjykatën e Apelit dhe më tej në rrethe", u shpreh Xhaxhi. Ajo evidentoi edhe ngarkesën e pabarabartë të punës. "Ka ardhur koha të ketë shpërndarje të barabartë. Nuk është e pranueshme që në disa gjykata gjyqtarët të kenë ngarkesë 700 dosje dhe një tjetër 100", tha ajo. Xhaxhi e cilësoi gjithashtu backlogun si një problem të rëndësishëm, duke theksuar se kjo situatë "i bën gjyqtarët të ndihen të braktisur".

Ndërsa Matilda Llangozi, kandidate për KLGJ nga gjykatat e shkallës së parë, tha se Këshilli duhet të jetë më pranë gjyqtarëve dhe problematikave të tyre.




"KLGJ duhet të jetë një institucion që dëgjon zërin e gjyqtarëve dhe, nëse do të më besohet kjo detyrë, do të përfaqësoj nga afër problemet, realitetin e gjykatave dhe dialogun me gjyqtarët", deklaroi Llangozi.

Ajo theksoi se pavarësia e gjyqësorit lidhet edhe me kushtet konkrete të ushtrimit të detyrës. "Shqetësimet e gjyqtarëve duhet të dëgjohen. Pavarësia nuk nënkupton vetëm mungesën e ndërhyrjeve nga jashtë sistemit, por edhe plotësimin e kushteve, plotësimin e vakancave, mbështetjen e gjyqtarëve dhe promovimin", u shpreh Llangozi.

Top Channel

I Aktualitet »



Shiu nuk do zgjasë! Fundjava me diell dhe temperatura vjeshte deri në 27-28 gradë celsius

25/09 12:33



"Të vijojë lufta ndaj korrupsionit"/ Nga komandant i NATO-s në ambasador në Tiranë. Media në SHBA: Si e gjen Eric Wendt Shqipërinë

25/09 12:32



Rreth 16 milionë kg mish derri nga Brazili, Bashkimi European e ndaloj, Shqipëria vazhdon të importojë me shumicë

25/09 12:18



"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

25/09 11:47



Kultivonin kanabis në pyll, arrestohet 22-vjeçari në Skarapar, bashkëpunëtori arratiset i armatosur

25/09 11:37



Video/ Grabitja e 1.5 mln lekëve dhe bizhuterive në Sarandë, TCh siguron pamjet, momenti kur hajdutët me maska dalin nga banesa me çantën e zezë

25/09 11:16

I Kryesore »



Debat te "Kultura"/ Zhupa:
Jashtë Kuvendit dhunoheshin
qytetarët, kërreë institucionesh
në shërbim të krimit. Malaj: Mos
i hidhni benzinë zjarrit,
s'mbrojmë askënd që...

25/09 12:39



Valteri kërkon
emarrjen e Veliajt në
mbledhjen e Këshillit Bashkiak:

"Të vijojë lufta ndaj
korrupsionit"/ Nga komandant i
NATO-s në ambasador në
Tiranë. Media në SHBA: Si e
gjen Eric Wendt Shqipërinë

25/09 12:32



"Ku jemi katandisur!"/ Ish-
deputeti Murrizi nxjerr videon e
sherrit në Durrës: Ky që e rrahin

Rreth 16 milionë kg mish derri
nga Brazili, Bashkimi European e
ndaloj, Shqipëria vazhdon të
importojë me shumicë

25/09 12:18



Mbledhja e KLGJ, gjyqtarët
pranojnë dialogun me Ramën:
Ulemi në tryezë, por nuk heqim

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.